



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2020:152479

Datë: 23.02.2021

Numri i dokumentit: 01533577

C.nr.443/2020

GJYKATA THEMELORE NE GJAKOVË-DEGA MALISHEVË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin Nehat Qelaj si dhe me Zyrtarin e Lartë për Bashkëpunim Profesional Visar Morina, në çështjen juridike të paditësit D.K. nga fshati Ll., Komuna e Malishevës, e përfaqësuar nga Av. N. K. nga Malisheva, ndaj të paditurës K.e M.- D. e A. e përfaqësuar nga Avokati Publik Komunal M. S., sipas bazës juridike kompensim I shujtës ditore, pas mbajtjes së seancës kryesore me datë 23.02.2021 merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET** në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit D. K. nga fshati Ll., Komuna e Malishevës.
- II. DETYROHET** e paditura K.e M. – D. e A. të K. së M. që paditësit, D. K. nga fshati Ll., Komuna e M. në emër të shujtës ditore, për periudhën nga data 18 prill 2017 deri më datën 08.06.2019, të përlllogaritur sipas shumës prej 2 euro për një ditë, t’ia kompensoj shumën e përgjithshme prej 810 euro, me kamat prej 8% nga dita e nxjerrjes së këtij aktgjykimi datë 23.02.2020 e deri në pagesën definitive të gjitha këto në afatin prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbartimit të detyrueshëm.
- III. DETYROHET** e paditura që paditëses t’ia paguajë shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën e përgjithshme të shpenzimeve 260 euro të gjitha këto në afat prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënimin e ekzekutimit të tij të dhunshëm.

A r s y e t i m

Paditësi, përmes të autorizuarit të tij Av. N.K. nga M., pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi ndaj të paditurës K.e M.- D. e A. lidhur me kompensimin e shujtave ditore pasi që sipas padisë paditësi ka punuar mësimdhënës në SHFMU “V. K.” në fshatin D. qe nga viti 01.09.1975 deri me date 08.06.2019 kur është pensionuar, ne te cilën punëdhënës ka qene e paditura D.K. për A. dhe E. ne M..

Paditësi ka punuar ne shkollës e larte cekur edhe gjate periudhës 18.04.2017 deri me date 08.06.2019, kurse e paditura nuk i ka bere kompensimin e shujtave ditore ne vlere prej 2 euro për

secilën dite pune te parapara me kontratën Kolektive te A. me date 18.04.2017. Me teje ne padi ka specifikuar periudhën përkatësisht ditët e punës.

Gjykata pas shqyrtimit paraprak të padisë së paditësit e ka njoftuar të paditurën me aktvendim mbi dhënien e përgjigjes në padi.

Gjate seancës përgatitorë dhe te shqyrtimit të mbajtur njëkohësisht i autorizuari i paditësit fillimisht deklaroj se: mbesim pran padis dhe kërkesë padis te parashtruar ne ketë gjykatë për mes se cilës kemi kërkuar kompensimin e shujtat ditore. Një e drejt e tillë rrjedh nga kontrata kolektive e arsimit ne Kosovë e cila është ne fuqi prej datës 18.04.2017. Ne bazë te kësaj paditësit e paditura ka qen e detyruar ti paguaj shujtat ditore për çdo di te punës, siç parashihet me nenin 35 pika 7 e kontratës ashtu që e paditura ka qen e obliguar qe te kompensoj ushqimin ose shujtën ditore ne vlerë prej 2 euro ne dit pasi një gjë e tillë parashihet po ashtu me kontratën kolektive siç u cek me lartë nga kjo qe u tha e sa i përket ushqimit kërkojmë shumen prej 810 euro duke llogaritur nga data 18 Prill 2017 e deri me datën 08.06.2019 ku dhe ka dalur ne pension. Nga gjykata kërkoj aprovomini e padis pasi qe një e gjë e tillë parashihet shprehimisht me kontratën kolektive te arsimit. Po ashtu i autorizuari i paditësit në fjalën përfundimtare deklaroj se: nga provat e parashtruara në seancën përgatitore si dhe ne ketë shqyrtim u vërtetua plotësisht se padia e paditëses është e bazuar. Prandaj nga gjykata kërkojmë aprovomini e saj dhe atë për kompensimin ne shumen prej 810.00 euro ne emër te shujtës te gjitha këto kammat prej 8% ne pajtim me ligjin e marrëdhënies detyrimeve nga dita e nxjerrjes se aktgjykimit. Sa i përket shpenzimeve i kërkojmë dhe i specifikojmë ashtu qe ne emër te padisë 104 euro, për taks gjyqësore 21 euro, dhe për ketë seancë shumen prej 135 euro.

I autorizuari i të paditurës deklaroi se: e kontestojmë padinë e paditësit si te pa bazuar për faktin Komuna nuk ka qen nënshkruese e kontratës kolektive te arsimit te vitit 2017 por kjo kontrata ka qen e nënshkruar nga Qeveria e Kosovës – MASHT. Andaj për këto kategori Komuna nuk ka ndarë buxhet dhe nuk ka mundur te planifikojnë mjete për shlyerjen e këtyre obligimeve pasi qe kjo është dashtë te parashihet nga niveli qendror Ministra e Arsimit, andaj i propozojmë gjykatës qe e njëjta te refuzohet. Po ashtu i autorizuari i te paditurës ne fjalën përfundimtare deklaroi se mbesim pran thëniete te deklaruar me lart duke e kontestuar padinë e paditësit për shujte për arsye që i parashtruam gjatë kësaj seance andaj propozoj gjykatës se me rastin e vendosjet këto çështje ti ketë parasysh pretendimet tona. Nuk kërkoj shpenzime, ndërsa palës paditëse ti refuzohen edhe shpenzimet me rastin e kërkesë padis.

Me qellim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike lidhur me çështjen konkrete juridike, gjykata me propozimin dhe pëlqimin e palëve pas përfundimit të seancës përgatitore menjëherë hapi shqyrtimin kryesor duke bërë administrimin e provave dhe atë: vendimi numër ... dt.05.06.2019, vërtetimi numër ... i dt.02.11.2020 lëshuar nga SHFMU “V. K.” D., vërtetimi mbi përvojën e punës numër ... dt.07.06.2019 lëshuar nga SHFMU “V. K.” D., kalendari për vitin shkollor për vitin 2018-2019 dhe 2019-2020.

Pas vlerësimit të te gjitha provave veç dhe veç dhe në lidhmëni me njëra tjetrën, në kuptim të nenit 8 të LPK-së, gjykata vlerëson se kërkesëpadia e paditëses është e bazuar dhe si të tillë e aprovoj në tërësi.

Në bazë të provave të sipërpërmendura gjykata vlerëson dhe vërtetoi se paditësi nga data e deri 08.06.2019 ka qene në marrëdhënie pune tek e paditura si mësimdhënës në Shkollën Filllore të Mesme të Ulët “V. K.” në Ll. ndërsa nga kjo data e fundit i njëjti ka dal në pension, dhe ky fakt

nuk është kontestues as edhe nga e paditura ndërsa vërtetohet edhe përmes vendimit të daljes në pension numër ... të datës 05.06.2011, por të njëjtit nuk i janë kompensuar mjetet në emër të shujtave ditore për periudhën 18 prill deri 31.12.2017, prej janar deri ne dhjetor 2018 si dhe prej janar 2019 deri 08.06.2019, andaj nga provat e administruara, si dhe konformë dispozitave të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017 në mes Ministrisë së Arsimit Shkencë dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovës dhe SBASHK lidhur me kompensimin në emër të shujtës ditore sipas neni 35 par.7 në të cilën përcaktohet se **“Të punësuarve, u sigurohet kompensimi për ushqim, gjatë punës për ditët e pranisë në punë, vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë punë, është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore, punëdhënësi i cili e ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restorantit a kuzhinës, ose një formë tjetër nuk ka obligim kompensimin për ushqim”** gjykata e aprovoj kerkesë padinë e paditësit si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Sipas nenit 8 parag.1 te Ligjit mbi Marrëdhëniet Detyrimeve **“Pjesëmarrësit në raportet e detyrimeve janë të detyruar që ti përmbushin detyrimet e tyre dhe janë përgjegjës për përmbushjen e tyre”** ndërsa në dispozitat e nenit 245 parg.1 të LMD-së, ka paraparë se **“Kreditori në marrëveshjet detyrimeve është i autorizuar që nga debitori të kërkoj përmbushjen e detyrimit e debitori është i detyruar ta përmbush me ndërgjegje këtë në tërësi ashtu si është e paraparë”**, meqenëse në rastin konkret është vërtetuar se paditësi ka qene në marrëdhënie pune tek e paditura deri kur është pensionuar, lidhur me kërkesën për kompensimin në emër të shujtës ditore u vendos që të njëjtën t’ia aprovojë sipas periudhës nga data 18 prill 2017 deri më datën 08.06.2019, periudhë gjatë të cilës paditësi ka punuar tek e paditura, e që vërtetohet nga vërtetimi 623/2020 te datës 02.11.2020 për vijueshmërinë në punë, po ashtu edhe nga kalendari i MASHT-së për vitin shkollor 2018-2019 dhe 2019-2020, andaj në këtë gjendje të vërtetuar faktike e detyroj të paditurën që paditësit t’ia paguaj shumat si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata shqyrtoi edhe pretendimet e të autorizuarit të të paditurës, por gjykata pretendimet e tilla i konsideroi të pa bazuara ngase e paditura lidhur me kompensimin e shujtave ditore obligohet në bazë të detyrimeve të cilat dalin nga Kontrata Kolektive, nënshkruese e të cilës është Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, përkatësisht në nenin 2 par.1.1 të kësaj kontrate lidhur me zbatimin e këtyre dispozitave përcaktohet se **“Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive, janë të zbatueshme për të gjithë të punësuarit në të gjitha institucionet publike dhe private të Arsimit Para universitar (parashkollor, fillor, të mesëm të ultë dhe të mesëm të lartë, shkolla special e qendra të kompetencës) dhe institucionet e arsimit të lartë në mbarë territorin e Republikës së Kosovës, të cilët janë anëtarë të SBASHK-ut”**, ndërsa dispozitat e par.1.2 përcaktohet se **“Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e Arsimit, (Komunat-DKA, KD të Universiteteve e institucioneve të arsimit të lartë, MASHT-in etj.) në sektorin publik dhe institucionet edukativo-arsimore private në mbarë territorin e Republikës së Kosovës”**.

Lidhur me kërkesën për kamatë, Gjykata ka vendosur në kuptim të nenit 382.1 dhe 2 të LMD-së.

Vendimin mbi shpenzimet procedurale gjykata e mori konform nenit 452.1 të LPK-së, dhe Rregullores për tarifatat e Avokatëve, duke detyruar të paditurën që paditësit t’ia paguajë dhe atë

në emër të parashtrimit të padisë në shumën prej 104.00 euro, në emër të taksës shumën prej 21.00 euro dhe në emër të përfaqësimit për një seanca nga avokati 135.00 gjithsejtë shuma e shpenzimeve të aprovuar në vlerë prej 260 euro.

Nga të lartcekurat u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi konformë nenit 38 dhe 143 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË-DEGA MALISHEVË
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil
C nr.443/2020 datë 23.02.2021

Gj y q t a r i
Nehat Qelaj

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 dite pas marrjes së të njëjtit, gjykatës së Apelit në Prishtinë e nëpërmjet të kësaj gjykate.